

BULETINI JAVOR I SËMUNDSHMËRISË INFEKTIVE - ALERT

JAVA 06, 6 – 12 Shkurt 2017

Për këtë periudhë, kanë raportuar 36 rrethe ose 100% (=36/36) e tyre

3 rrethe ose 8% (=3/36) e tyre kanë raportuar me telefon, faks, postë:
HAS, M. MADHE, PEQIN,

33 rrethe ose 92% (=33/36) e tyre kanë raportuar me postë elektronike:

BERAT, BULQIZË, DELVINË, DEVOLL, DIBËR, DURRËS, ELBASAN, FIER, GJIROKASTËR, GRAMSH, KAVAJË, KOLONJË, KORÇË, KRUJË, KUÇOVË, KURBIN, LEZHË, LIBRAZHD, LUSHNJE, MALLAKASTËR, MAT, MIRDITË, PËRMET, POGRADEK, PUKË, SARANDË, SHKODËR, SKRAPAR, TEPELENË, TIRANË, TROPOJË, VLORE.

Pa raportim brenda afatit, asnjë rreth ose 0% (=0/36) e tyre:

NUMRI TOTAL I RASTEVE TË SINDROMAVE TË SURVEJANCËS “ALERT” NË JAVËN 06

	JAVA 06
DIARRE PA GJAK	1.300
DIARRE ME GJAK	0
INF. RESP. TE SIPËRME	8.417
INF. RESP. TE POSHTËME	4.835
RASH ME TEMPERATURË	12
VERDHËZA	0
HEMORRAGJI ME TEMPERATURË	0
SUSPEKT MENINGITIS	0
ETHE TË PASHPJEGUESHME	1
Numri i Njësive Raportuese	400
% e Njësive Raportuese	93% (400/427)

Rash me temperaturë

5 raste janë raportuar nga rrethi i Fierit, nga 1 rast nga rrethet Mat dhe Kavajë, 4 raste nga rrethi i Tiranës dhe 2 raste nga rrethi i Vlorës. Nga hetimi epidemiologjik dhe konsultat me mjekët e familjes, mjekun infeksionist dhe epidemiolog të rretheve një nga rastet e rrethit të Kavajës u suspektua për Rubeolë. Rastet e tjera nuk janë suspekt fruth apo rubeolë por varicelë.

Duke u nisur nga shpërthimet epidemike të Fruthit që po ndodhin në disa shtete të Europës dhe Ballkanit, në komunikimin me epidemiologët e rretheve është theksuar përforcimi i Survejancës së sindromit “rash makulopapular me temperaturë” nga mjekët Pediatër dhe Infeksionistë.

Suspekt Rubeolë


Rasti është i moshës 3 muajsh i raportuara nga rrethi i Kavajës. Ekzaminimi rezultoi negativ për IgM kundër Rubeolës dhe Fruthit dhe Parvovirus

Ethe të Pashpjegueshme


Rasti është i grupmoshës 45-59 vjeç të raportuara nga rrethi i Pogradecit. Më pas diagnoza rezultoi “Brucelozë”. Rasti është hospitalizuar.

Infeksione Respiratore

Trendi në kohë i Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas javëve




Shpërndarja e Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme sipas Grup-moshave




Trendi në kohë i Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme paraqitet i qëndrueshëm në javën e 06 krahasuar me javën paraardhëse, java 05.

Diarre pa gjak

Trendi në kohë i Diarreve pa Gjak sipas javëve




Shpërndarja e Diarreve pa Gjak sipas Grup-moshave




Trendi në kohë i “Diarre pa gjak” paraqet rritje në javën 06 krahasuar me javën paraardhëse, java 05.

Trendi i “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” në javët 40 – 06 të sezonit 2015-2016 dhe të sezonit 2016-2017. Numri i rasteve.




Në javën e 6-të të vitit 2017 vërehet një trend i qëndrueshëm i numrit të infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme dhe ky numër është 15% më i ulët krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.


Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas grupmoshës në javën e 6-të të vitit 2017. Numri i rasteve dhe Incidenca (raste/10.000)




Krahasimi i aktivitetit të “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas sezoneve (javët 40 – 20) dhe Pragu Epidemik. Raste/100.000



Frekuenca e hasjes së “Infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme” sipas rretheve në javën 05 dhe 06 të vitit 2017. Incidenca (raste/10.000)




Trendi i “Diarreve pa Gjak” në javët 40 – 06 të sezonit 2015-2016 dhe të sezonit 2016-2017. Numri i rasteve.



Në javën e 6-të të vitit 2017 vërehet një trend në ritje i numrit të rasteve të “Diarreve pa gjak” dhe ky numër është 4% më i ulët krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Frekuenca e hasjes së “Diarreve pa gjak” sipas rretheve në javën 05 dhe javën 06 të vitit 2017. Incidenca (raste/10.000)



Shumica e rasteve janë raportuar nga Urgjenca e Spitaleve dhe janë të shpërndara, pa grumbullime dhe lidhje epidemiologjike ndërmjet tyre.

Nivelet e Raportimit për javën e 06 sipas rretheve, në përqindje.

